



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

WWW.UMED.EDU.AL



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 1806 / Prot.
/2

Tiranë, më 21 .06 .2022

URDHËR
Nr. 64 , datë 21 .06 .2022

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR EKSPERTIN E JASHTËM QË DO TË
ANGAZHOHET NË PROCESIN E PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË
APLIKANTËVE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK
2022-2023**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë...”, në Statutin e UMT, Urdhrin nr. 63 , datë 20.06.2022 “Për ngritjen e komisionit të monitorimit dhe grupit teknik të punës për pranimet e kandidatëve që aplikojnë në programet e ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2022-2023” të Rektorit të UMT-së, si dhe në shkresën nr. 1806/1 prot, datë 21.06.2022 të Drejtorisë së Administrimit Akademik dhe Kurrikulës, Rektorati i UMT,

URDHËROJ

I. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatit si dhe dokumentacion përkatës për ekspertin e jashtëm që do të angazhohet në procesin e pikëzimit dhe renditjes së aplikantëve që vijnë nga matura shtetërore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2022-2023, janë si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e shkencave informatike ose të aplikuara;
2. Të njohë ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
3. Të njohë kurrikulën e re dhe të vjetër të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë;
4. Të ketë eksperiencë në përlllogaritjen e pikëve të kandidatëve që kanë aplikuar në institucionet e arsimit të lartë;
5. Preferohet të ketë njohuri të avancuara të programit Excel, në përdorimin e funksioneve të kërkimit, logjike dhe të përputhjes (Match/Vlookup/index).

Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kërkesë me shkrim;
2. Jetëshkrim sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për secilin program përkatës studimi);
 5. Dokument që vërteton eksperiencën në përllogaritjen e pikëve si edhe njohuri të programeve, përkatësisht sipas pikës 4 dhe 5 të kriterëve.
- II. Kandidatët e interesuar të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Sektorin e protokoll-arkivës në Rektoratin e UMT ose nëpërmjet postës në adresën: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005 Tiranë.
- III. Afati i dorëzimit të dokumenteve është nga data 27.06.2022 deri më 01.07.2022.
- IV. Mënyra e vlerësimit: përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje.
- V. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sektori i Burimeve Njerëzore dhe IT për publikimin e tij në faqen zyrtare të UMT.

